



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ**

Procesverbal -Tipi i kontrates - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashk dokumentat e tenderit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Rikonstruksion i rruges auto Kryqezimi Bardhet-Iballe”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45112400-9 Punime germuese

VLERA E FONDIT LIMIT – 2 499 685.5 (dy milion e katerqind e nentdhjete e nente mije e gjashtëqind e tetedhjet e pese pike pese) **leke pa TVSH.**

Në bazë të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Fushë-Arrëz**, ka hartuar procesverbalin për argumenimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikimin për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

1.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për periudhën 2021, 2022, 2023 që tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Ligjin nr. 160/2020 "Për prokurimin publik" nën 77, pikë 3, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nën 43 pikë 4., sipas shtojcës 7 pikë 1 germa dh tek DST.

Përcaktimi i vitit të kërkuar për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe vëllimin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë.

2.2.2 Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk mund të tejkalojë vlerën e parashikuar të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 43, pikë 2 germa b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme :

a) pune te ngjashme per nje objekt te vetem ne nje vlere jo me te madhe se 30% e vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate pese viteve te fundit, nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

b) pune te ngjashme deri nje kufi, ku vlere totale monetare e puneve te kryera, e marre se bashku gjate pese viteve te fundit, eshte jo me e madhe se vlere limit e kontrates qe prokurohet.

Plotësimi i një prej kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

-Për të vërtetuar përvojën e mëparshme nga OE duhet të paraqiten:

a) vertetim te leshuar nga nje ent publik, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, per te vertetuar permbushjen e suksesshme te puneve.

b) per pervojen e meparshme te realizuar me sektorin privat, kerkohet si deshmi, vertetim, per permbushjen me sukses te kontrates, ku te shenohen vlere, afati i perfundimit te kontrates dhe natyra e punes se bere, e shoqeruar me fatura tatimore dhe cdo lloj dokumenti tjeter, qe parashikohet nga legjislacioni ne fuqi, qe provon realizimin me sukses e puneve.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 5 dhe neni 55 pika 4 germa a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën.

Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik

2.3.2 Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licensat e mëposhtme :

NP-1 A

NP-4 A

NS-18 A

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. neni 39 pika 6 germa a.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
N.P – 1 A	Punime Germimi	Percaktimet ne preventiv	A
N.P - 4 A	Rruge autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvaji, metor, hekurudhe mekavo dhe pista aeroportuale	Percaktimet ne preventiv	A
N.S- 18 A	Punime gjeodezike	Percaktimet ne preventiv	A

2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën **10 (dhjete)** personave të siguruar për tre mujorin përpara dates se zhvillimit te tenderit. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj dhe listepagesat e shoqërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa ç. Në përlllogaritjen e numrit të punonjësve, njësia e prokurimit ka marrë parasysh numrin e punonjësve që nevojitet për realizimin e objektit dhe afatin e kryerjes së punimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar stafin inxhinierik/teknik me kontratë pune të vlefshme, diplomë/deftese, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë, si më poshtë:

- Ing. Ndërtimi **1 (nje)**
- Teknik topograf **1 (një)**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77 , pika 4, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë një liste personeli kryesor të nevojshme për të zbatuar objektin e

prokurimit dhe /ose komponentet e saj, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Është kërkuar inxhinier ndërtimi i cili është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet, për secilin nga zërat e punimeve ndërtimore, referuar preventivave të punimeve, kontrollit të punimeve të betonit të pranishme në preventiv si: ndërtim mure betoni, pusetat beton arme, puseta shpërndarje dhe pusetat e kontrollit , breza, themele etj.

Është kërkuar topograf, pasi sipas relacionit teknik dhe specifikimeve teknike, është parashikuar se kontraktori që do të marrë përsipër zbatimin e objektit inxhinierik, duhet të bëjë dendësimin e pikave të bazamentit, duke realizuar vlerat e paracaktuara të dhëna në specifikimet teknike të objektit, në lidhje me saktësinë e realizimit të piketimit. Nga shoqëria kërkohet dhe një azhurnim i saktë i këtij investimi në përfundim.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar e të pajisur deshmi perkatese:

- Muratore 3 (tre)
- Specialist Ndertimi 2 (dy)
- Drejtues mjetesh 2(dy)
- Manovrator 1(nje)

Punonjësit e mësipërm duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë.

- Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar 10 punetore te thjeshte dhe te figuroje ne liste-pagesat e shoqerise .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjim nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, pika 4, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa c. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë nje liste personeli kryesor të nevojshme për të përmbushur me sukses kontratën.

2.3.6 Disponimi ose mundësia e sigurt e disponimit në paisjet/kapacitetet e mëposhtme teknike, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamion veteshkarkues, kapaciteti total mbajtës minimumi 12 ton	në pronesi ose me qera	copë	1
2	Kamionçine 1-2 Ton	në pronesi ose me qera	copë	1

3	Eskavator me goma/zinxhir	në pronesi ose me qera	copë	1
4	Minieskavator	në pronesi ose me qera	copë	1
5	Betoniore dore 0.25 m3	në pronesi ose me qera	copë	1
6	Betoforma druri	në pronesi ose me qera	m2	20
7	Motogjenerator	ne pronesi ose me qera	cop	1

Paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, si më poshtë vijon:

- Kokore minimumi 15 copë
 - Jeleke fosforeshente minimumi 15copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 1 copë
- Tabela paralajmëruese/shirita identifikues për sigurinë në objekt.

Mjetet dhe pajisjet e lartpërmendura duhet të jenë në pronësi ose me qera dhe ofertuesi duhet ti paraqesë ne formularin e deklarimin për disponimin e makinerive (sipas shtojcës 9) .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 39 pika 6 germa d.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponon makinerite e nevojshme per kryerjen e punimeve te parashikuara ne preventiv, objekt i kontrate, si dhe per ekzekutimin, e permbushjen me sukses te kontrates.

2.3.7 Kandidati ofertues duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:

- **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .
- **OHSAS 18001:2007** ose **45001:2018** mbi “Shëndetin dhe sigurimin në punë “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim .
- **ISO 14001:2018** mbi “Sistemet e menaxhimit të ambjentit “ lëshuar nga Institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.160, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” neni 77, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 44 pika 3.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë, si dhe standartet e menaxhimit të mjedisit. Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nënligjore të sipërcituara, autoriteti kontraktor vlerëson se: operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të plotësojnë kërkesat e standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate, në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen, njësia e prokurimit ka kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarde të cilësi të cilat mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive, sigurimin e konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, etj.

Certifikatë ISO 45001-2018 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, të cilat përfshijn vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës, zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.